



ABETARJA E TË BURGOSURIT

Të drejta dhe detyrime




MINISTRIA E DREJTËSISË, TRANSPARENCËS
DHE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKRETARIA E PËRGJTHSHME E POLITIKËS ANTIKRIMINALE

ABETARJA E TË BURGOSURIT

Të drejta dhe detyrime



REDAKTIMI:

Ouiliam Alloskofis,
Dr. Sociolog, Burgu Korydallos

FORMULIMI PËRFUNDIMTAR:

Sofia Jovanoglou, Dr. Jurispodence,
Zyra e Sekretarit të Përgjiithshëm të
Politikës Antikriminale

VËREJTJE KRITIKE:

M. Anagnostaki, J. Arhontidis,
J. Thrapsaniotis, N. Pimenidis,
I. Stalikas, J. Psaraki, S. Mengjesi

STUDIM – FAQOSJE:

Anna Karakonstanti

BOTIM:

Shtypshkronja Kombëtare,
Shkurt 2017

PËRKTHEU NGA GREQISHTJA:

Kristo Çakuli, Profesor i Filologjisë,
Ambasada e Shqipërisë në Athinë



Burgu është një ambient jetese i përbashkët. Pra, detyrimisht, përshkohet prej rregullave, me qëllim që qëndrimi për të burgosurin dhe shërbimi për nëpunësin të jetë i garantuar dhe pa probleme. **"Rregullat e lojës"** në burg janë një ndërthurje të drejtash dhe detyrimesh. Një përmbledhje e këtyre rregullave paraqitet në këtë libër modest.

Koha e burgimit është e vështirë, pa liri, larg nga të afërmit, nga miqtë, pa veprimtaritë e dashura. Por, jo, pa të **drejta**. Njohja dhe ushtrimi i tyre përforcojnë dhe mbrojnë dinjitetin tënd, por ndërkaq, detyrojnë edhe drejtorinë që të ushtrojë administrimin në bazë të rregullave. Por njëkohësisht, ekzistojnë edhe **detyrime**, respektimi i të cilëve, jo vetëm do të të ndihmojë që të dalësh sa më shpejt nga burgu, por do të bëjë edhe kohën e qëndrimit tënd në të më të lehtë.

Ushtrimi i të drejtave dhe respektimi i detyrimeve kontribuojnë në shmangien e paligjshmërisë. Sigurisht, synimi përfundimtar i zbatimit të rregullave është respektimi i dinjitetit njerëzor dhe mbrojtja e jetës. Por, në çdo rast, **drejtësia** nuk ndalon në portën e burgut.

EFTYKIS FYTRAKIS,

Sekretar i Përgjithshëm i politikës Antikriminale



P Ë R M B A J T J A

Arsimimi	f. 10	A
Detyrime	f. 10	D
E drejta e votimit Ekstradim	f. 12	E
Grevë urie (e drejta për shëndetin)	f. 12	G
Higjenë, pastërti	f. 12	H
Informim, argëtim, stërvitje gjimnastikore dhe sportive	f. 13	I
Korrespondenca	f. 13	K
Kurim, shkëputje (nga droga)		
Kategoritë e burgjeve		
Komisioni Qendror i Transferimeve. (K.E.M.)		
Kontrulli disiplinor		
Këshilli Disiplinor		
Këshilli i Punësimit të të Burgosurve		
Këshilli i Burgut		
Komunikimi telefonik		
Lejet	f. 20	L
Lirim me kushte		
Lirim me kushte për të burgosurit invalidë		
Lirim (përgatitje)		
Liria fetare		
Mundësi që ke, gjatë momentit të hyrjes tënde në burg	f. 23	M
Mbikëqyrja nga prokurori		





P Ë R M B A J T J A

Ndihmë (juridike)	f. 24	N
Orari i vizitave	f. 25	O
Punësimi	f. 25	P
Përlllogaritja pozitive e ditëve të burgimit		
Punë korrektuese		
Programi i orareve		
Raportimi te autoritetet dhe shprehja e ankesave	f. 29	R
Robra	f. 30	Rr
Sende që ndalohet të mbash në qeli gjatë qëndrimit në burg	f. 34	S
Sende që lejohen të mbahen në qeli		
Sigurimi dhe mbrojtja e jetës personale		
Shkurtim i afatit të burgimit	f. 38	Sh
Shkelje disiplinore dhe masa disiplinore		
Shëndeti		
Transferim	f. 44	T
"Unazë elektronike" (lirim i parakohshëm me mbikëqyrje elektronike)	f. 44	U
Ushqimi		
Vuajtja e dënimit	f. 46	V
Vuajtja e dënimit (të heqjes së lirisë) nën statusin e përkufizimit shtëpiak		
Vizita		



ABETARJA

- ▶ Arsimimi
- ▶ Detyrime
- ▶ E drejta e votimit
- ▶ Ekstradim
- ▶ Grevë urie (e drejta për shëndetin)
 - ▶ Higjenë, pastërti
 - ▶ Informim, argëtim, stërvitje gjimnastikore dhe sportive
 - ▶ Korrespondenca
- ▶ Kurim, shkëputje (nga droga)
 - ▶ Kategoritë e burgjeve
- ▶ Komisioni Qendror i Transferimeve (K.E.M.)
 - ▶ Kontrolli disiplinor
 - ▶ Këshilli Disiplinor
 - ▶ Këshilli i Burgut
- ▶ Komunikimi telefonik



Arsimimi ¹

Në mjaft burgje të Greqisë funksionojnë njësi pedagogjike, në të cilat ofrohet arsimim bazë dhe i vazhdueshëm. Titujt studimorë janë të barabartë me analogët e shkollave të së njejtës kategori arsimore, pa paraqitur në tekstet e tyre se u fituan në burg.

Shërbimi social mund të të informojë për programet arsimore që funksionojnë në burgun, ku ti vuan dënimin e heqjes së lirisë.

A

Ke të drejtë:

- Të bësh kërkesë që të ndjekësh një nga programet arsimore (siç janë Shkolla Fillore, Shkolla Nëntëvjeçare, Shkolla e Shansit të Dytë, Shkollat e Kualifikimit Profesional) ose programin e kualifikimit profesional që zhvillohet në burgun, në të cilin ndodhesh.
- Të ndjekësh studimet e tua në arsimimin e shkallës së tretë (universitete, institute të larta etj) apo të studiosh në institut arsimor të njohur ose me korrespondencë ose duke marrë leje arsimore, pas kërkesës në Këshillin Disiplinor. Me dekrete të veçanta saktësohet mundësia për të ndjekur mësimet e arsimimit të shkallës së tretë jashtë burgut me kushtin e mbikëqyrjes elektronike (statusi i Unazës Elektronike).

D

Detyrime

Detyrimet e tua bazë janë:

- Të ndjekësh udhëzimet e ligjshme dhe urdhërat e personelit të burgut dhe të respektosh programin.
- Të mos qarkullosh jashtë kufijve të godinës tënde pa leje ose shoqërim.
- Të mos komunikosh me të burgosur të godinave të tjera dhe të mos komunikosh (përmes letrave) me të burgosur të tjerë pa leje.
- Të bashkëpunosh me nëpunësit gjatë zhvillimit të kontrolleve rregullta apo të jashtëzakonshme të sendeve personale dhe gjatë kontrolleve trupore që realizohen në ambient të veçantë nga nëpunës të së njejtës gjini me një procedurë, e cila nuk prek dinjitetin tënd.

¹ (Kapitujt renditen sipas alfabetit shqip).

- Të pranosh, pas urdhërit të prokurorit, drejtorit ose kryegardianit, kontrollin radiografik dhe radioskopik nga mjek ose të mbetesh deri në tri ditë në ambient të veçantë nën mbikëqyrje, nëqoftëse ekziston dyshimi se ke fshehur në trupin tënd lëndë droge.
- Të mos pengosh ndriçimin e qelisë/sallonit dhe të ndihmosh apelin (numurimin) dhe inspektimin okular.
- Të respektosh të burgosurit e tjerë, të sillesh me kulturë ndaj personelit dhe të mbash qëndrim korrekt në seancat e këshillave dhe në takimet me të afërmit dhe avokatët.
- Të deponosh paratë e tua në arkën e burgut dhe të dorëzosh libreza deponimesh, çeqe, karta krediti dhe sende të tjera të çmuara personale për ruajtje të garantuar në magazinën e burgut.
- Të mos deponosh para në llogari bankare të të burgosurve të tjerë, përveç rasteve kur bëhet fjalë për bashkëshort-e ose për të afërmit e tu, dhe të mos shkëmbesh karta telefoni ose sende të tjera.
- Të mos pish duhan në ambientet e vizitave dhe të mos marrësh nga vizitorët karta telefoni ose sende, të cilat jepen ose shiten në dyqanin (kantinën) e burgut.
- Të flasësh shkurt, kur përdor telefonat e përbashkëta me karta, dhe të respektosh radhën.
- Të mos mbash ose të përdorësh celularë.
- Të zbatosh me përgjegjësi dhe kujdes detyrën që të është besuar.
- Të bësh përdorim të mirë dhe të mos shkaktosh dëme me dashje në vegla, materiale, pajisje dhe godina.
- Të kujdesësh për hijgenën personale dhe pastërtinë e rrobave, çarçafëve dhe batanijeve dhe të mbash të sistemuara sendet e tua personale.
- Të kujdesësh për pastërtinë e ambienteve të përbashkëta.
- Gjatë largimit nga burgu (lirim, transferim ose ekstradim), të dorëzosh dyshekun, batanijet, çarçafët dhe jastëkët që kishë në përdorim.

E drejta e votimit

Mund të votosh në zonën elektorale të burgut për zgjedhjet në parlamentin kombëtar, në parlamentin europian dhe në referendumet e mundshme, nëqoftëse je i regjistruar në listat elektorale, pas kërkesës tënde, dhe nuk ke humbur të drejtat e tua elektorale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Ekstradim

E

Ke të drejtën e ekstradimit në vendin tënd për vazhdimin e vuajtjes së dënimit, përderisa vendimi përkatës është i formës së prerë:

- Nëqoftëse je shtetas prej vendi të tretë, i cili ka nënshkruar Marrëveshjen e Strasburgut.
- Nëqoftëse je shtetas i vendit-anëtar të Bashkimit Europian (BE) dhe ke banim stabël në vend të BE-së (Ligji 4307/2014, FEK A' 246).

G

Mund të bësh kërkesën përkatëse në sekretarinë e burgut, nga ku mund të marrësh një botim të veçantë dhe informatat e domosdoshme.

H

Grevë urie (e drejta për shëndetin)

I burgosuri që deklaron se po hyn në grevë urie, ka të drejtën që të ftojë mjek të burgut ose mjek të preferencës së tij, me qëllim që të ekzaminohet gjendja e shëndetit të tij trupor, psiqik dhe shpirtëror (Neni 31 Pika 1 e Kodit të Riedukimit).

Higjenë, pastërti

Ke të drejtë:

- Të jetosh në qeli personale, nëqoftëse e lejojnë kushtet e ndërtesave të burgut.
- Të kërkoh mjetet e domosdoshme për higjenën personale dhe pastërtinë e robave të tua, nëqoftëse je pa të ardhura.
- Të blesh produkte higjenike nga dyqani (kantina) e burgut.
- Të marrësh gjatë hyrjes tënde në burg një dyshek, një jastëk, dy këllëfë jastëku, dy batanije, katër çarçafë, dy peshqira fytyre, dy peshqira banjoje.
- Të përdorësh çarçafë, batanije dhe peshqira të ngjyrave të ndryshme prej atyre që të furnizon burgu (pa rrypa anësorë si garniturë).

- Të kesh përditë ujë të ngrohtë, në banjot dhe ambientet e larjes së rrobave.
- Të lash rrobat e tua në lavatriçet e burgut, nëqoftëse disponon.
- Të pastrohen përditë ambientet e përbashkëta dhe ndërtesat nga shoqëri pastrimi, si edhe të dezinfektohen rregullisht (ambientet).
- Të informohesh për çështje higjienike dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.

Informim, argëtim, stërvitje gjimnastikore dhe sportive

Ke të drejtë:

- Të kesh në qelinë tënde pajisje televizive (e pronësisë tënde apo e burgut) me hands free, me qëllim që të mos shqetësohen të burgosurit e tjerë. Televizori mund të ketë kanal dixhital vetëm me leje nga Këshilli i Burgut dhe me shpenzime personale.
- Të furnizohesh me gazeta, revista dhe libra ose të marrësh hua nga biblioteka (e burgut).
- Të kërkosh informata për gjendjen tënde juridike.
- Të marrësh pjesë në programet defruese-kulturore dhe në biseda me shkencëtarë apo të ftuar të tjerë.
- Të përdorësh kompiuter vetëm në ambiente të veçantë për qëllime arsimore, pas vendimit të Këshillit të Burgut.
- Të ecësh dhe të stërvitesh në oborrin e burgut apo në ambientet sportive të paktën 1 orë në ditë, nën mbikëqyrjen e gardianëve ose të gjimnastëve.
- Të marrësh pjesë në programe të stërvitjes me formacione grupi, me kusht që të mos pengojnë funksionimin e burgut.

Korrespondenca

Ke të drejtë:

- Të dërgosh dhe të marrësh letra pa kufizim dhe në kohën e duhur përmes shërbimit të burgut në kutinë postare. Leje nga Këshilli i Burgut do të marrësh vetëm në rastet kur dëshiron që të komunikosh (përmes letrave) me një të burgosur tjetër.

I

K

- Të kërkosh nga shërbimi social që të mbulojë shpenzimet e korrespondencës tënde, nëqoftëse provon se je pa të ardhura.
- Sekreti i korrespondencës tënde mbrohet nga ligji. Kontrolli i përmbajtjes së saj mund të bëhet vetëm për arsye sigurimi apo për zbardhjen e krimeve tepër të rënda prej autoriteteve kompetente.

Kurim, shkëputje (nga droga)

K

E drejta në ofrimin e shërbimeve shëndetsore të nivelit të njejtë me atë të popullsisë së përgjithshme përfshin edhe të drejtën e kurimit për persona me probleme të përdorimit të lëndëve ndërvarese (produkte droge). Për këtë qëllim funksionojnë në mjaft burgje, njësi këshillmore dhe programe kurative. Gjithashtu, në Burgun e të Droguarve në Eleona të Thivës (K.A.T.K.) funksionon program special (për shkëputjen përfundimtare nga droga) nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë.

Nëqoftëse je përdorues i ndërvarur i drogës, ke të drejtë:

- Të kërkosh pjesëmarrjen tënde në program këshillmor apo kurativ, i cili zhvillohet në burgun ku ndodhesh.
- Të kërkosh transferimin tënd në K.A.T.K. (në burgun e Eleonas në Thivë) ose në burg tjetër, ku funksionon program kurativ, për ta ndjekur, nëqoftëse plotëson kriteret e ligjit.
- Të kërkosh që të mos transferohesh në burg tjetër, në të cilin nuk mund të vazhdosh ndjekjen e programit këshillmor apo kurativ.
- Të kërkosh, sipas dispozitave të plota të Ligjit 4139/2013, nga Komisioni special që parashikohet në Nenin 31, që të miratojë përfshirjen tënde në program kurativ trupor dhe psikik të burgut.

Mund të informohesh nga shërbimi social dhe personeli shkencor i burgut, në të cilin ndodhesh, për programet këshillmore dhe të kurimit që funksionojnë.

Kategoritë e burgjeve

Burgjet ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Të përgjithshme.
- Speciale.
- Kurative.

Burgjet e përgjithshme klasifikohen si më poshtë:

- Të tipit të parë.
- Të tipit të dytë.

Burgje speciale janë: burgjet e të Rinjve, burgjet agrare dhe Magazina Qendrore e Materialeve të Burgjeve.

Burgje kurative janë Spitali i Përgjithshëm i të Burgosurve, Spitali Psikiatrik i të Burgosurve dhe Qendra e Kurimit të të Burgosurve të Droguar në Eleonas të Thivës.

Komisioni Qendror i Transferimeve. (K.E.M.)

Përbëhet nga tre anëtarë, funksionon në Ministrinë e Drejtësisë dhe shqyrton kërkesat e transferimeve për cilëndo arsye, përveç atyre që vendos gjykata (Neni 9 i Kodit të Riedukimit).

Kontrolli disiplinor

Gjatë kontrollit tënd disiplinor, ke të drejtë:

- Të informohesh me shkresë për shkëljen disiplinore për të cilën akuzohesh.
- Të ftohesh në Këshillin Disiplinor, me qëllim që të mbrosh veten dhe të justifikohesh.
- T'i drejtohesh Këshillit Gjyqësor kundër vendimit të Këshillit Disiplinor brenda 5 (pesë) ditëve nga komunikimi i vendimit.
- Të kërkohsh apelimin e vendimit, ndërprerjen e fuqisë së tij ose faljen e dënimit të izolimit në qeli personale, nëqoftëse ekziston rrezik serioz për jetën tënde ose shëndetin tënd ose, nëqoftëse me akte të veçanta, provon se është rritur ndjenja e përgjegjësisë tënde.

Këshilli Disiplinor

Këshilli Disiplinor përbëhet prej tre vetash, ku marrin pjesë prokurori i shërbimit si kryetar, drejtori i burgut dhe përfaqësuesi më i vjetër shoqëror si anëtarë (Neni 70 Pika 1 e Kodit të Riedukimit).

K

Këshilli i Punësimit të të Burgosurve

Këshilli i Punësimit të të Burgosurve përbëhet prej pesë vetash, ku marrin pjesë prokurori i shërbimit si kryetar, drejtori i burgut, përfaqësuesi shoqëror më i vjetër, kryegardiani dhe agronomi i njësisë agrare (ose përgjegjësi i vendit të punës ose drejtuesi i shërbimit teknik ose shkencëtar tjetër i specializuar) si anëtarë. Kërkesat e punësimit shqyrtohen sipas numrit rendor të datës (më të vjetër) të deponimit të kërkesës. Vendimet e këshillit merren pas intervistës me të burgosurit e interesuar (Neni 41 Pika 3 e Kodit të Riedukimit).

Këshilli i Burgut

Këshilli i Burgut përbëhet prej tre vetash, ku marrin pjesë drejtori i burgut si kryetar, përfaqësuesi shoqëror më i vjetër dhe shkencëtari specialist më i vjetër si anëtarë (me zëvendësuesit e tyre, ashtu siç parashikohet në Nenin 10 Pika 1 të Kodit të Riedukimit).

Këshilli i Burgut konsultohet vazhdimisht me specialistë të Ministrisë së Drejtësisë dhe me rangje të ndryshme gjykatash.

Në seancat e Këshillit të Burgut merr pjesë, pa të drejtë vote, kryegardiani i burgut. Në seancat mund të marrë pjesë, pas ftesës së organit ose dhe me iniciativë të tij, prokurori i shërbimit, si edhe i burgosuri i interesuar, pas kërkesës së të burgosurit dhe pasi të jetë gjykuar e domosdoshme nga Këshilli i Burgut (Neni 10 i Kodit të Riedukimit).

Komunikimi telefonik

Ke të drejtë:

- Të komunikosh nga telefonat e përbashkëta (kartotelefonat), përsa kohë sallonët dhe qelitë janë të hapura, me persona, për të cilët ke marrë leje që të të vizitojnë, si edhe me avokatin tënd.
- Të blesh karta telefoni me vlerë të përgjithshme deri në 25 euro, apo të kërkesha nga institucioni (burgu), nëqoftëse je pa të ardhura.
- Të kërkesha që të komunikosh përmes telefonit në çdo orë me të afërmit e tu, nëqoftëse ndodh diçka e jashtëzakonshme në familjen tënde.



Secreti i komunikimit tënd mbrohet me ligj. Kontrolli (i komunikimit tënd) mund të bëhet (vetëm) për arsye sigurimi ose për zbardhjen e krimeve tëpër serioze nga organet kompetente.





ABETARJA

- ▶ Lejet
- ▶ Lirim me kushte
- ▶ Lirim me kushte për të burgosurit invalidë
- ▶ Lirim (përgatitje)
 - ▶ Liria fetare
- ▶ Mundësi që ke, gjatë momentit të hyrjes tënde në burg
- ▶ Mbikëqyrja nga prokurori
 - ▶ Ndihmë (juridike)
 - ▶ Orari i vizitave
 - ▶ Punësimi
- ▶ Përlllogaritja pozitive e ditëve të burgimit
 - ▶ Punë korrektuese
 - ▶ Programi i orareve
- ▶ Raportimi te autoritetet dhe shprehja e ankesave
 - ▶ Robra



Lejet

Ke të drejtë të kërkosh leje-dalje, nëqoftëse plotëson kriteret e ligjshme:

- Leje të rregullt** nga 1 deri në 6 ditë për integrimin tënd gradual dhe përgatitjen tënde për lirim nga burgu. Afati i lejes tënde mund të zgjatet deri në 9 ditë, vetëm pasi të plotësosh 2/5 e dënimit, ose 12 vjet në rastin e burgimit të përjetshëm. Leje të re mund të kërkosh pas kalimit të dy muajve nga data e leje-daljes së mëparshme. Totalisht, ditët e lejes së rregullt, pa llogaritur ato të udhëtimit, mund të jenë maksimum 45 ditë në vit. Për dhënien e lejes vendos Këshilli Disiplinor, me kushtet dhe kriteret që përcakton Ligji i Kodit të Riedukimit (Nenet 54-56). Nëqoftëse refuzohet për të dytën herë radhazi kërkesa jote për dhënien e lejes së rregullt, mund t'i drejtohesh Këshillit Gjyqësor brenda pesë ditëve nga data e komunikimit ndaj teje të vendimit refuzues. Gjithashtu, ke të drejtë që të kërkosh përkrahje financiare, kur merr lejen e rregullt, për të mbuluar shpenzimet krejtësisht të domosdoshme, që të udhëtosh me mjetet publike të transportit, por me kusht që të provosh me fakte se je pa të ardhura.
- Leje të jashtëzakonshme** nga prokurori i shërbimit për 24 orë maksimum, ose me shoqërim ose jo. Leja e jashtëzakonshme jepet për plotësimin e nevojave familjare, profesionale apo nevojave të tjera të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara të karakterit të veçantë. Leje të jashtëzakonshme jep edhe administrata dhe drejtori i burgut, duke informuar prokurorin e shërbimit, në rastet e vdekjes së bashkëshortit-ës ose të të afërmit deri në shkallën e dytë dhe për vizita të bashkëshortit-ja ose të të afërmi deri në shkallën e dytë, në rastet e gjendjes kritike të shëndetit të tyre.
- Leje arsimore për vazhdimin** e shkollës tënde të çdo niveli arsimor në bazë të dispozitave që parashikohen nga ligji. Leja arsimore jepet nga Këshilli Disiplinor.



Lirim me kushte

Mund të lirohesh para kohe, me kusht që të kesh kryer një pjesë të dënimit të heqjes së lirisë, afat i cili parashikohet për çdo kategori të veçantë, analogjikisht me dënimin që vendosi gjykata. Për sqarime të mëtejshme, mund të kërkosh ndihmën e sekretarisë së burgut. Për lirin tënd vendos Këshilli Gjyqësor. Ndërkaq, në rast se nuk respekton kushtet që përmban vendimi i lirit ose, ndërkohë, dënohesh për shkelje tjetër, atëhere do të kthehesh në burg që të vuash gjithë pjesën tjetër të dënimit që mbeti.

L

Lirim me kushte për të burgosurit invalidë

Nëqoftëse ke probleme serioze shëndeti ose invaliditet të shkallës së lartë, mund të lirohesh para kohe, me qëllim që të mos rëndohet akoma më shumë shëndeti yt. Për këtë arsye, mund të kërkosh ekzaminim e domosdoshëm nga mjek specialist ose Qendra e Ekzaminimit të Invaliditetit. Por, ndërkaq, nëqoftëse kryen shkelje të re, atëhere do të kthehesh në burg dhe do të vuash gjithë pjesën tjetër të dënimit që mbeti dhe, njëkohësisht, humbet të drejtën që të lirohesh sërishmi me këto dispozita ligjore (Neni 110A i Kodit Penal).

Lirim (përgatitje)

Pas lirit tënd është e mundshme që të përballosh vështirësi praktike në jetën tënde të përditshme ose probleme përshtatjeje. Madje, bën vaki që të mos njohësh se ku do të drejtohesh për ndihmë. Që të përgatitësh më mirë kthimin tënd në jetën familjare dhe shoqërore, që të përballosh më lehtë vështirësitë për kërkimin e punës, mund të bashkëpunosh me shërbimin social dhe personelin e specializuar (psikologun, sociologun dhe përfaqësuesin shoqëror të burgut, në të cilin ndodhesh i burgosur).

Gjithashtu, pjesëmarrja jote në programe arsimore dhe programe kualifikimi profesional, si edhe në grupe speciale kuruese dhe në veprimtari të tjera që organizohen në burg, mund të të ndihmojë që të perfeksionosh aftësitë e tua dhe të vish në kontakt me persona dhe institucione që mund të të ndihmojnë gjatë periudhës së lirit tënd.

<<EPANODOS>> (RIKTHIMI) është një person juridik i së drejtës private që funksionon nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe merret ekskluzivisht me çështje që kanë lidhje me persona, të cilët lirohen nga burgu. Gjithashtu, informata për <<EPANODOS>> dhe për institucione dhe shërbime të tjera, të cilat funksionojnë afër banesës tënde, mund të marrësh nga shërbimi social dhe personeli i burgut në të cilin ndodhesh i burgosur.

EPANODOS, Qendër e Riintegritit të të Liruarve (nga Burgu)

Rruga Derigny 28-30, Sheshi Viktorias, Kodi Telefonik (TK) 104 34 Athinë.

Telefona: 210-8815904, 210-8815032, fax. 210-8251109

E-mail: epanodos@epanodos.org.gr,

<http://www.epanodos.org.gr>

L

M

Liria fetare

Ke të drejtë:

- Të ushtrosh detyrimet e tua fetare rregullisht në tempull ose ambient tjetër të përshtatshëm, i cili është sajuar për këtë qëllim në burgun, në të cilin ndodhesh.
- Të komunikosh dhe të kërkosh leje që të pranosh vizita nga përfaqësues të besimit tënd.
- Të kërkosh dietolog specialist për çështje fetare dhe, nëse është e mundur, të plotësohet dëshira jote.

Mundësi që ke, gjatë momentit të hyrjes tënde në burg

Gjatë hyrjes tënde në burg ke për detyrim:

a) Të deklaroosh me shkrim:

- Nëse rrezikon jeta jote dhe duhet të mbrohesh.
- Nëse ka të burgosur, me të cilët ke probleme.
- Nëse ka të burgosur, me të cilët ke marrëdhënie farefisnie.

- Nëse je i huaj, të informohet Ambasada e shtetit, prej të cilit ke marrë shtetësinë, përderisa e dëshiron, për evenimentin e burgosjes tënde.
- Nëse dëshiron që të informohet ndonjë person, në rast se paraqitet nevoja.

b) Të marrësh informata nga personeli i burgut (drejtori apo kryegardiani apo sekretaria apo shërbimi social) për:

- Të drejtat e tua.
- Detyrimet e tua.
- Çështje praktike të përditshme.

c) Të flasësh me një anëtar të personelit shkencor të burgut apo me një nëpunës të burgut, në rast se:

- Të shqetëson një problem personal tepër i veçantë.
- Ekziston ndonjë çështje familjare e rëndësishme.
- Të shqetësojnë në mënyrë të veçantë çështje juridike ose nevojitet kontribut ndihmeje.

M

N

Mbikëqyrja nga prokurori

Prokurori i rajonit ku ndodhet burgu (prokurori i shërbimit) ka për kompetencë të mbikëqyrë kushtet e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe ligjshmërinë e vuajtjes së dënimit të heqjes së lirisë. Përsa i përket të drejtës tënde që të kërkosh takim me prokurorin e shërbimit, shiko në kapitullin 3 <<Raportimi te autoritetet dhe shprehja e ankesave>>.

Gjithashtu, prokurori i shërbimit mund të kontrollojë dhe të hetojë pa paralajmërim dhe në çdo kohë të gjitha instancat drejtuese të burgut, që ndodhet në kompetencën e tij. Sipas dispozitave të ligjit, është personi juridik më i lartë i rajonit, në të cilin ndodhet edhe burgu.

Ndihmë (juridike)

Nëqoftëse je pa të ardhura, mund të bësh kërkesë te prokurori i shërbimit, me qëllim që të emërohet avokat për ty, duke deponuar, njëkohësisht edhe:

- Dokumente, si për shembull deklaratë tatimore, vërtetim bilanci tatimor, vërtetim i përfitimit të kompesimit social ose të asistencës sociale të papunësisë, procesverbale të vendimeve gjyqësore, në të cilat duket se nuk ke pasur avokat ose nuk ke pasur mundësinë e pagimit të dënimeve financiare ose për shndërrimin e dënimeve të heqjes së lirisë në dënime financiare etj.
- Fotokopje të thirrjes.
- Shënim nga përfaqësuesi shoqëror.
- Fotokopje të akteve të llogarisë personale nga zyra e llogarisë së burgut në të cilin ndodhesh.

Në rast se kërkesa jote refuzohet, atëhere mund t'i drejtohesh organit direkt më të lartë brenda tri ditëve nga komunikimi i refuzimit.

Orari i vizitave

Orari i funksionimit të vizitave për avokatët dhe të afërmit është:

- **08.00 para dreke – 11.00 para dreke dhe 15.00 pas dreke** – gjysëm orë para perëndimit të diellit gjatë periudhës dimërore.
- **08.00 para dreke – 11.00 para dreke dhe 15.00 pas dreke – 18.00 pas dreke** gjatë periudhës verore.

Informata për ditët dhe orarin e saktë të vizitave, si edhe ndryshimet e mundshme që mund të bëhen për arsye të jashtëzakonshme, do të gjesh në komunikatat e drejtorisë nëpër godina.

Punësimi

Ke të drejtë:

- Të bësh kërkesë në Këshillin e Punësimit të të Burgosurve, që të punosh nën statusin e përllogaritjes pozitive të ditëve të punës.
- Të shprehësh preferencën tënde për vendin e punës që dëshiron. Kërkesa jote do të shqyrtohet në bazë të numrit rendor.



P

- Të kesh siguracion në IKA gjatë rrezikut të aksidentit punësor, nëqoftëse punon në vende (pune) të caktuara ose ndjek program të kualifikimit profesional.

Punësimi i të burgosurit nuk ka karakter dënimi apo shfrytëzimi (Neni 40 Pika 1 e Kodit të Riedukimit). Në çdo burg ekzistojnë vende pune në procese apo shërbime ndihmëse për plotësimin e nevojave funksionuese të burgut. Gjithashtu, në mjaft burgje funksionojnë njësi agrare apo artizanale. Për ndarjen e të burgosurve në vendet e punës, për përcaktimin e orarit dhe për kriteret e punësimit, vendimet i merr Këshilli i Punësimit të të Burgosurve.

Përlllogaritja pozitive e ditëve të burgimit

Çdo ditë burgimi përlllogaritet pozitivisht, nëqoftëse je:

- Në vend pune ose në punishte produktive të burgut që vuan dënimin.
- Në program arsimor (shkollë të çdo kategorie), gjatë gjithë periudhës së vitit, ose në program të kualifikimit profesional.
- Në vend pune në burg agrar, në brigadë ndërtimore dhe në grup teknik.
- Në program kurativ (të shkëputjes nga droga, alkooli etj).

Përlllogaritja e ditëve të punës bëhet nga prokurori i shërbimit, pas propozimit të Këshillit (kompetent) të Punësimit të të Burgosurve. Prokurori i shërbimit, në rast se je dënuar për shkelje disiplinore, mund të mos lejojë ose të anulojë përlllogaritjen pozitive të ditëve të burgimit tënd, dhe atëhere ke të drejtë që t'i drejtohesh Këshillit Gjyqësor brenda 10 (dhjetë) ditëve, pas informimit tënd për vendimin përkatës.

Punë korrektuese

Ke të drejtë të kërkohësh përfshirjen tënde në programet speciale për punë korrektuese afër vendit të banimit tënd, kur je i dënuar me heqje lirie:

- Për një pjesë të dënimit tënd, nëqoftëse ai (dënimi i heqjes së lirisë) nuk është shndërruar në dënim financiar dhe me kusht që të kesh deponuar kërkesën tënde në Këshillin Gjyqësor (Neni 64 i Kodit të Riedukimit).
- Për të gjithë dënimin tënd, nëqoftëse ai (dënimi i heqjes së lirisë) është shndërruar në dënim financiar dhe nuk ke mundësinë ekonomike që të paguash këtë shndërrim, dhe pasi të bësh kërkesën tënde në Gjykatën, e cila ka marrë vendimin e dënimit (Neni 82 i Kodit Penal).



Programi i orareve

Programi i orareve të burgut paraqitet si më poshtë:

- **07.30 para dreke:** Zgjimi – Hapja e qelive dhe salloneve – Apeli i të burgosurve.
- **07.45 para dreke:** Shpërndarja e mëngjesit.
- **08.00 para dreke – 12.00 pas dreke:** Stërvtitje, punë, arsimim, pjesëmarrje në programe, kohë e lirë.
- **12.00 pas dreke:** Shpërndarje e drekës.
- **12.30 pas dreke – 15.00 pas dreke:** Pushim i drekës.
- **15.00 pas dreke** deri gjysëm orë përpara perëndimit të diellit: Stërvtitje, punë, arsimim, pjesëmarrje në programe, kohë e lirë.
- **Gjysëm orë përpara perëndimit të diellit:** Mbyllja e burgut – Shpërndarja e darkës – Apeli përfundimtar.

Informata të mëtejshme për programin e orarëve:

- Lejohet qëndrimi i të burgosurve në godinat me kangjella të mbyllura gjatë periudhës dimërore deri në orën **20.30 pas dreke** dhe gjatë periudhës verore deri në orën **21.00 pas dreke**. Pas këtyre orëve të burgosurit mbyllen në qelitë apo sallonet e tyre deri në mëngjesin e ditës së nesërme.
- Respektimi i programit të orarëve është i detyrueshëm.
- Në raste të veçanta të burgosurit qëndrojnë jashtë qelive dhe salloneve në godinat me kangjella të mbyllura:
 - a) Më 31 dhjetor deri në orën 00.30 para dreke të datës 1 janar.
 - b) Gjatë festave tradicionale fetare, kombëtare dhe festave lokale gjatë orëve të drekës.
 - c) Në ditët e nxehta, kur temperatura kalon kuotën e 36 gradëve Celsius gjatë orëve të drekës.

- d) Gjatë orëve të drekës dhe 1 ose 2 orë, më tepër nga mbyllja e përcaktuar e darkës, kur merren masa të jashtëzakonshme nga shteti për përballimin e temperaturave të larta.
- Gjatë festave dhe ditëve të veçanta programi që zbatohet nuk përmban arsimim dhe pjesëmarrje në programe të kualifikimit profesional.
 - Lejohet, **pas vendimit të Këshillit të Burgut**, shmangia nga programi i orareve për të burgosur, të cilët marrin pjesë në arsimim ose ndodhen në punë, brenda ose jashtë burgut.

Informata më të hollësishme për të drejtat e tua dhe për funksionimin e brendshëm të burgjeve do të gjesh në Kodin e Riedukimit (Ligji 2776/1999, FEK A' 291/1999), Në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Burgjeve të tipit A' dhe B' (Vendimi Ministral 58819/2003, FEK B' 463/2003), si edhe në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Burgjeve të të Rinjve (Vendim Ministral 47503/2005, FEK B' 889/2005).

Raportimi te autoritetet dhe shprehja e ankesave

Ke të drejtë:

- Të kërkohsh me shkrim takim me prokurorin e shërbimit, drejtorin apo përgjegjësit e sektorëve, si edhe me personelin shkencor (psikologun, sociologun, përfaqësuesin shoqëror). Me urdhër ditor të drejtorit, i cili vendoset në pozicion të dukshëm në ambientet e burgimit, përcaktohen ditët dhe orët e takimeve për çdo muaj.
- Të informosh me shkrim Këshillin e Burgut në rastet e veprimeve të paligjshme kundër teje apo udhëzimeve të parregullta të personelit. Nëqoftëse Këshilli i Burgut refuzon kërkesën tënde, atëherë, brenda 15 ditëve nga momenti i komunikimit të refuzimit, apo, në rast se nuk të përgjigjen, brenda një muaji nga deponimi i ankesës tënde, mundet që përmes raportimit me shkrim të kërkohsh ndihmën nga Këshilli Gjyqësor (Neni 6 Pika 1 e Kodit të Riedukimit).

Rr

- Të kërkosh ndihmën nga prokurori i shërbimit, nëqoftëse të paraqesin pengesa gjatë vizitave që pranon, gjatë bisedave telefonike apo komunikimi tjetër, si edhe për çdo çështje tjetër që ka lidhje me trajtimin tënd të rregullt dhe sigurinë tënde.
- Të dërgosh relacione ose letra në institucione kombëtare, siç është Avokati i Qytetarit apo në organizma ndërkombëtare. Letrat duhet të lexohen direkt nga drejtoria e burgut, por pa censuruar përmbajtjen e tyre (Neni 6 pika 3 e Kodit të Riedukimit).

Avokati i Qytetarit ka tashmë edhe cilësinë e <<Organizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturave>> dhe formave të tjera të ashpra të trajtimit çnjerëzor apo poshtëruese dhe mund të vizitojë të gjithë ambientet ku ekzekutohet vendimi i dënimit të heqjes së lirisë dhe të flasë me të burgosurit. Gjithashtu, kontrole të rregullta dhe të befasishme në ndërtesat e burgjeve kryhen nga Organi i Mbikëqyrjes dhe i Kontrollit të Burgjeve, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikës Antikriminale dhe të Riedukimit, përmes organeve të saj ushtron mbikëqyrjen e funksionimit të burgjeve të vendit, kujdeset për rehabilitimin e akteve të paligjshme të mundshme dhe plotësimin e kërkesave të të burgosurve dhe kontrollon përgjegjësit kompetentë. (Neni 6 Pika 2 e Kodit të Riedukimit).

Rroba

Ke të drejtë:

- Të veshësh rrobat që ti dëshiron.
- Të kërkosh nga shërbimi social rroba dhe këpucë, nëqoftëse ke nevojë. Gjithashtu, mund të kërkosh edhe rroba edhe këpucë të tjera, nëqoftëse punon, sipas natyrës së punës.





- ▶ Sende që ndalohet të mbash në qeli gjatë qëndrimit në burg
- ▶ Sende që lejohen të mbahen në qeli
- ▶ Sigurimi dhe mbrojtja e jetës personale
 - ▶ Shkurtim i afatit të burgimit
- ▶ Shkelje disiplinore dhe masa disiplinore

ABETARJA



- ▶ Shëndeti
- ▶ Transferim
- ▶ "Unazë elektronike" (lirim i parakohshëm me mbikëqyrje elektronike)
 - ▶ Ushqimi
 - ▶ Vuajtja e dënimit
- ▶ Vuajtja e dënimit (të heqjes së lirisë) nën statusin e përkufizimit shtëpiak
 - ▶ Vizita



Sende që ndalohet të mbash në qeli gjatë qëndrimit në burg

Gjatë hyrjes tënde fillestare në burg, ndalohet të kesh me vete:

- Sapunë në formë të ngurtë, të lëngët apo pluhuri.
- Pastë dhëmbësh, shkurë për t'u rruar, kremra në ambalazhime të ndryshme, aroma.
- Padio, radiokasetofona, kasetofona, pajisje për prodhimin e valëve të zërit përveç radios, kompiutera të vegjël, lojëra elektronike, celularë, axhenda elektronike.
- Stilolapsa dhe tubete shkrimi, nëse nuk mund të kontrollohen.
- Jastëqe, dysheqe, mbulesa, velenxa, batanije të njejta me ato që furnizon administrata të burgosurit.
- Cigare dhe duhan të çdo ambalazhi.
- Letra për banjo, kartopeceta, pane, servieta.
- Bizhuteri të çdo lloji.
- Këpucë, me pjesë metalike apo me shollë të dyfishtë, me aeroshollë, ose çizme, të cilat nuk mund të kontrollohen.
- Xhupe të trasha me mbushje pambuku, nëqoftëse nuk mund të kontrollohen.

Gjithashtu, nuk lejohet që të kesh me vete:

- Celular (ndalohet edhe mbajtja e celularit edhe përdorimi i tij), si edhe pjesë shoqëruese të tij, siç janë karrikuesi, karta SIM etj.
- Sende me majë të mprehtë, të cilat mund të përdoren si armë të ftohta.
- Lëndë narkotike apo alkoolike, pajisje për prodhimin apo përdorimin e tyre.
- Elemente pasurore apo sende që u takojnë ekskluzivisht të burgosurve të tjerë.
- Karta telefonike me vlerë totale më të madhe se 25 euro.

Para, stolira, sende të çmuara dhe objekte të tjera, përveç atyre që lejohen, i dorëzohen për ruajtje në arkën e llogarisë dhe në magazinë gjatë momentit të hyrjes tënde në burg. Sendet dhe objektet personale të tua regjistrohen në një regjistër të veçantë, në mënyrë të hollësishme nga nëpunësi kompetent, nënshkruan vetë ti personalisht për dorëzimin dhe të kthehen me proces-verbal në rast se transferohesh apo lirohesh nga burgju. Në rast se lind mosmarrëveshje nëse një send lejohet apo jo që ta mbash, vendimi përfundimtar i takon kryegardianit.

Sende që lejohen të mbahen në qeli

Lejohet që të mbash në qeli ose në sallonin tënd sende të përdorimit imediat dhe të përditshëm, pa pjesë metalike. Të gjitha sendet sëbashku duhet të kenë volum total, sa dimensionet e një valixheje të tipit mesatar dhe jo më të madhe, dhe në to përfshihen:

- Robra të domosdoshme, këpucë, veshje të brendshme, pantofla, pa gozhda metalike, toka ose pjesë të tjera të rrezikshme.



S

- Orë dore që punon, unazë martese (apo fejese).
- Një simbol fetar.
- Varëse plastike rrobash.
- Vurçë dhëmbësh, makina plastike për t'u rruar, krehra plastike, çakmakë të tipit BIC.
- Radio të vogël, televizor të vogël me hands free.
- Syze dielli apo optike.
- Prerëse të vogël për thonjtë, pa ingranazh thike.
- Lapsa, stilolapsa, letra, libra, gazeta, revista, të gjitha këto në numur të vogël dhe përderisa mund të kontrollohen.
- Çarçafë, këllëfë jastëku, peshqirë dhe batanije pa rrypa anësore si garniturë.
- Enë plastike, lugë, piruna, taper dhe termus të vogël, nëse mund të kontrollohet.
- Çantë udhëtimi prej basme të butë, prej materiali plastik ose elastik, pa fund të dyfishtë ose mbështetëse metalike.
- Çdo lloj produkti që lejohet të blesh nga dyqani apo kantina e burgut.
- Zonë elastike për mbështetjen e mesit, zonë speciale për dhjamët, paterica, pajisje ortopedike, pas miratimit nga mjeku i burgut dhe përderisa ato mund të kontrollohen.
- Ilaçe, pas miratimit të mjekut.
- Pajisje për qëllime arsimore ose artistike dhe për shfrytëzimin e kohës së lirë, pas kërkesës tënde dhe miratimit nga Këshilli i Burgut, përderisa mund të kontrollohen.

Sigurimi dhe mbrojtja e jetës personale

Administrata e burgut ka për detyrë garantimin e jetës së çdo të burgosuri. Nëqoftëse dikush të sillt në mënyrë të dhunshme apo të shqetëson vazhdimisht, mund të drejtohesh te prokurori i shërbimit, te drejtori dhe te



Sh

cilido nëpunës nga personeli i burgut, sidomos te kryegardiani. Dhunë dhe shqetësim është kur dikush të godet apo të kërcënon.

Në bazë të dispozitave të ligjit 4322/2015, dënohen tashmë në mënyrë më të rreptë veprime, të cilat përmbajnë ushtrim dhune dhe janë kryer nga të burgosur në dëm të të burgosurve të tjerë ose kundër nëpunësve të burgut, madje edhe gjatë kohës së leje-daljes. Dënimet që jepen për veprimet e mësipërme (përderisa janë të shkallës kriminale ose të kryera me dashje) ekzekutohen të plota pas mbarimit të afatit fillestar të burgimit dhe nuk mund të njësohen me dënime të tjera suplementare që janë vendosur apo do të vendosen (Neni 94 Pika 4 e Kodit Penal).

Shkurtim i afatit të burgimit

Afati i burgimit tënd mund të shkurtohet në rastet e mëposhtme, të cilat kanë për qëllim lehtësimin e pasojave të burgimit dhe kthimin tënd gradual në shoqëri:

- Lirim me kushte.
- Lirim me kushte për të burgosurit invalidë.
- Përlllogaritje pozitive të ditëve të burgimit.
- Punë korrektuese.



- Lirim i parakohshëm nën statusin e mbikëqyrjes elektronike (apo të ashtuquajturës "unaza elektronike").

Për të gjitha rastet e mësipërme mund të të informojnë shërbimet e burgut, në të cilin ndodhesh. Gjithashtu, mund të kërkosh ndihmën e avokatit tënd.

Shkelje disiplinore dhe masa disiplinore

Shkeljet disiplinore dhe masat (dënimet) disiplinore përshkruhen shkurtimisht në ligjin përkatës. Kompetent për marrjen e masave disiplinore dhe për dhënien e shpërblimeve është **Këshilli Disiplinor**, që funksionon në çdo burg. Është e domosdoshme që të kesh dijeni për sa më poshtë:

- Shkeljet disiplinore dhe masat analoge të tyre janë:



Sh

Kategoria e parë:

Masa disiplinore: izolimi në qeli speciale deri në 10 (dhjetë) ditë, transferim, ndalim punësimi për 1 (një) vit, 16-30 gradë dënimi, për:

- a) Mosbindje ndaj udhëzimeve të ligjshme të personelit të burgut.
- b) Dezertim i dhunshëm në bashkëpunim me të tjerë.
- c) Ushtrim dhune ose kërcënim për ushtrim dhune kundër nëpunësve.
- d) Ushtrim dhune trupore kundër të burgosurve të tjerë.
- e) Ofendim ndaj lirisë seksuale.
- f) Krijim sendesh të rrezikshme.
- g) Hyrje, mbajtje, përdorim etj. i lëndëve narkotike ose alkoolike.
- h) Shkatërrim i pasurisë materiale të burgut me vlerë të madhe.
- i) Akt korruptimi ndaj një anëtari të personelit të burgut.

Kategoria e dytë:

Masa disiplinore: ndalimi i punësimit për 6 muaj ose 1-15 gradë dënimi, për:

- a) Vjedhje sendesh me vlerë ose përdorim i paligjshëm i tyre, sende të cilat u takojnë të burgosurve të tjerë.
- b) Mbajtje parash ose sendeve të paligjshme.
- c) Kërcënim ose ushtrim dhune psikologjike ndaj të burgosurve të tjerë.
- d) Shitje produktesh të përdorimit ekskluziv, p.sh. të ilaçeve.
- e) Organizim lojrash të ndaluara.
- f) Dezertim i të burgosurit.
- g) Tentativë e shtirur për vetvrasje, vetplagosje, kapërdim sendesh.
- h) Sharje dhe ofendime kundër personelit ose të burgosuri tjetër.
- i) Shprehje sistematike e ankesave të pabazuara dhe të gënjeshtërtë.

Kategoria e tretë:

Masa disiplinore: ndalim punësimi ose kualifikimi për 2 (dy) muaj ose 6-15 gradë dënimi, për:

- a) Pjesëmarrje në lojrat e ndaluara.
- b) Krijim, mbajtje ose përdorim sendesh të ndaluara (përveç të rrezikshmeve që i përmendëm pak më lart).
- c) Mungesë higjene personale dhe pastrimi të qelisë, sallonit dhe ambienteve të përbashkëta.
- d) Nxitje ndaj të burgosurve të tjerë që të kryejnë shkelje disiplinore.

Gradat e dënimit merren parasysh në lirimin me kushte, në dhënien e leje-daljes, përlllogaritjen pozitive të ditëve të dënimit etj.

Masat disiplinore paraqiten si më poshtë:

- a) Izolimi në qeli speciale në 2 (dy) vjet.
- b) Transferimi disiplinor në 1 (një) vit.
- c) Gradat e dënimit në 6 (gjashtë) muaj.
- d) Ndalimi i punësimit.

Sh



Sh

Shëndeti

Ke të drejtë:

- Të ekzaminohesh nga mjeku gjatë hyrjes tënde në burg dhe çdo herë tjetër që e kërkon me shkrim.
- Të ekzaminohesh nga mjek privat, në prani të mjekut të burgut, me shpenzimet e tua, pas kërkesës tënde në Këshillin e Burgut.
- Të marrësh – në praninë e infermierit ose të nëpunësit tjetër të autorizuar – ilaçe me receta të psikiatrit.
- Të kurohesh në Spitalin e të Burgosurve ose në spital tjetër publik, nëqoftëse shëndeti yt e ka të nevojshme.
- Të marrësh dijeni për rezultatet e analizave të tua mjekësore.
- Të mos pranosh, pa miratimin tënd, (ose pa lejen e prokurorit të shërbimit), analiza mjekësore, ndërhyrje kirurgjikale ose trajtim farmaceutik, përveç rasteve kur je mbartës i sëmundjeve infektuese apo ngjitëse. Nëqoftëse refuzon, në rastin e fundit, hyn përkohësisht në karantinë.
- Të mos pranosh në asnjë rast që t’u nënshtrohesh eksperimenteve mjekësore ose të llojit tjetër.

Si i burgosur ke të drejtën e trajtimit mjekësor dhe farmaceutik në të njëjtin nivel me atë të popullsisë së përgjithshme (Neni 27 Pika 1 e Kodit të Riedukimit). Përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve shëndetsore nëpër burgjet e kanë sëbashku Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetsisë. Të burgosur të sëmurë, kurimi i të cilëve nuk është i mundur brenda ambienteve të burgjeve, transferohen ose në spital publik brenda kufijve të prefekturës ku ndodhet burgju, ose, nëqoftëse nuk është i mundur kurimi në spitalin në fjalë, në spitalin publik më të afërt të prefekturës ku funksionon tjetër burg. Spitali i të Burgosurve "Agios Pavlos" dhe Spitali Psikiatrik i të Burgosurve në Koridallos mbulojnë deri në një farë mase nevojat e kurimit të të burgosurve, që sëmuren gjatë vuajtjes së dënimit të heqjes së lirisë ose paraqesin probleme shqetësuese të shëndetit psiqik.



T

U

Transferim

Mund të kërkosh me shkrim që të transferohesh në burg tjetër, për arsye personale, familjare, arsimore, kurative ose për arsye të punësimit tënd (p.sh. në burg agrar). Është e këshillueshme që arsyet që paraqet t'i justifikosh me dokumente ose prova të tjera. Këshilli i Burgut do të shprehë një mendim dhe Komisioni Qendror i Transferimeve (K.E.M.), i cili funksionon në Ministrinë e Drejtësisë, do të vendosë përfundimisht nëse do të transferohesh dhe ku do të transferohesh.

"Unazë elektronike"

(lirim i parakohshëm me mbikëqyrje elektronike)

Nëqoftëse je dënuar me burgim të përkohshëm dhe vendi i banimit tënd stabël ndodhet në Prefekturën e Attikës dhe të Selanikut, mund të kërkosh që të lirohesh para kohe, me kushtin e pranimit të statusit të mbikëqyrjes elektronike, deri në momentin e vendimit përfundimtar të lirimimit, sipas dispozitave të Nenit 105 të Kodit Penal. E njejta procedurë ka vlerë edhe kur ndodhesh nën statusin e të akuzuarit për krime, hetimi i të cilave (krimeve) ndodhet në kompetencën e Gjyqit të Shkallës së Parë të Athinës, të Pireut dhe të Selanikut, sipas dispozitave konkrete që përcakton Ligji 4205/2013, FEK (Gazeta Qeveritare) A' 242, dhe Dekreti Presidential 62/2014, FEK A' 105. Shpenzimet për vendosjen e <<Unazës Elektronike>> të rëndojnë ty, përveç rastit kur je pa të ardhura, dhe atëhere ke të drejtë që të kërkosh vendosjen falas të pajisjes elektronike.

Ushqimi

Ke të drejtë:

- Të hash tre vakte (mëngjes, drekë, darkë), në bazë të programeve të ushqimit të burgut.
- Të blesh ushqime ose produkte të tjera të lejueshme nga dyqani (kantina), me paratë që ke në llogarinë personale bankare.
- Të mbulosh shpenzimet e dietës së veçantë për arsye shëndeti, pas ekzaminimit të mjekut ose për arsye fetare.



V

- Të gatuash ushqimin tënd me leje të drejtorit dhe pas miratimit të mjekut, përderisa ekziston nevoja e dietës së veçantë ose e ushqimit suplementar për arsye shëndeti.
- Të të sjellin gjellë dhe ushqime gjatë vizitave (por jo fruta), të cilat mund të kontrollohen lehtë, e shumta deri edhe dy herë në muaj, pas lejes së Këshillit të Burgut.
- Të kërkosh nga shërbimi i burgut, përderisa ekziston mundësia, që në ditët e festave të Vitit të Ri, të 25 Marsit, të Pashkëve, të Shën Mërisë (15 gusht), të 28 Tetorit dhe të Krishtlindjeve, ashtu si edhe në festat lokale etnike dhe lokale fetare, nëqoftëse e dëshiron, të të jepet pije alkoolike (birë ose verë). Në çdo rast, duhet të kujdesësh që të mos shpërdorosh besimin apo mirëkuptimin e personelit të shërbimit të burgut, në të cilin vuan dënimin e heqjes së lirisë, pasi çdo devijim nga rregullat dhe çdo shkelje disiplinore regjistrohet në dëmin tënd.

Vuajtja e dënimit

Afati i burgimit tënd llogaritet nga shërbimet e burgut (sekretaria), në bazë të dënimit që të është dhënë nga vendimi i formës së prerë të gjykatës, pas zbritjes së kohës së paraburgimit (domethënë, të burgimit të përkohshëm). Nëqoftëse ekzistojnë më shumë (se 1) vendime dënimi të formës së prerë kundër teje, atëhere afati i burgimit tënd do të llogaritet në bazë të vendimit të unifikimit të dënimeve. Nëqoftëse nuk ka vendim të unifikimit të dënimeve, përmes shërbimeve të burgut apo avokatit tënd, mund të bësh kërkesë në gjykatën kompetente.

Vuajtja e dënimit nën statusin e përkufizimit shtëpiak

Në rast se je dënuar me heqje lirie deri në dhjetë vjet, ke të drejtë pas kërkesës tënde në Këshillin Gjyqësor të rajonit ku je i burgosur, që të vuash dënimin në banesën tënde, në rastet e mëposhtme:

- Kur je mbi 75 vjeç.
- Kur je nënë me fëmijë të mitur, derisa të plotësojë fëmija moshën 8 vjeç.

Vizita

Ke të drejtë që të pranosh, nëqoftëse e dëshiron, vizita të bashkëshortit-es dhe të të afërmeve deri në shkallën e 4-t (hollësisira më të shumta mund të mësoh nga shërbimi social i burgut), vizita të cilat mund të zgjasin, të paktën gjysëm orë (domethënë, jo më pak se 30 minuta).

- Një herë në javë, nëqoftëse je i burgosur.
- Dy herë në javë, nëqoftëse ndodhesh nën statusin e paraburgimit (nuk je dënuar ende me vendim të formës së prerë).
- Pa kufi, nëqoftëse je dënuar për borxhe apo shpërdorime financiare, ose nëqoftëse je i huaj <<i>përkohshëm>> që pret ekstradimin tënd.

Me leje nga Këshilli i Burgut mundesh:


- Të pranosh vizita edhe të personave të tjerë, të paktën një herë në 15 ditë.
- Të kërkosh leje për takime pa mjete ndarëse me bashkëshortin-en dhe fëmijët, në ambient tepër të përshtatshëm.
- Të pranosh vizitë edhe nga persona të tjerë apo institucione, të cilët mund të të ushtrojnë ndikim pozitiv.
- Të pranosh vizita nga përfaqësues diplomatikë apo konsullorë të shtetit tënd, nëqoftëse je i shtetas i huaj.

Me leje nga prokurori i shërbimit mundesh:

- Të takohesh (ti si i-e burgosur) me bashkëshortin-en ose me të afërm të tu deri në shkallën e dytë, që ndodhen të burgosur në të njëjtën kompleks ndërtimor të burgut tënd.
- Nëqoftëse je nënë, ke të drejtë të kesh me vete fëmijën tënde apo fëmijët e tu, derisa të mbushin moshën 3 vjeç, në ambient të përshtatshëm.
- Nëqoftëse nuk ke familje dhe as komunikim me të afërm, atëherë mund të deklarosh në shërbimin social të burgut një person, i cili mund të të përkrahë.
- Mund të pranosh vizita nga avokati yt pa kufij numerikë apo kohorë, jashtë kohës së përcaktuar (sipas rregullores) për takimet me avokatët.

Falenderojmë drejtoritë e **Shkollës së Shansit të Dytë (SDE - "Jeorgios Zouganelis")** dhe të **Institutit të Kualifikimit Profesional (IEK) të Burgut të Korydallos**, si edhe **kursantët dhe të diplomuarit e shkollave të mësipërme**, për kontributin e tyre, përmes miratimit që na dhanë për ekspozimin e veprave të tyre të artit figurativ në këtë botim modest.





Skica e faqes së parë, ashtu si edhe të gjitha veprat e artit figurativ që përfshihen në këtë libër, janë krijime të kursantëve të **Shkollës së Shansit të Dytë (SDE - "Jeorgios Zouganelis")** dhe të **të diplomuarve të Institutit të Kualifikimit Profesional (IEK)** të Burgut Korydallos.



(Punë 496/2016)